

Rezultatet finale të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, 2023

**Të dhënat e publikuara do të jenë objekt revizionimi*

Tiranë, më 18 Shkurt 2025: Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve ka për qëllim të ofrojë informacion mbi strukturën ekonomike, financiare dhe karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve të regjistruara në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve dhe aktive në sektorët ku ato operojnë, në periudhën referuese Janar - Dhjetor 2023.

Në vitin 2023, kanë qënë 117.292 ndërmarrje ekonomike aktive në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke shënuar një rritje me 3,4 %, krahasuar me vitin 2022. Ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë zënë përqindjen më të lartë të numrit të ndërmarrjeve me 35,7 %.

Numri i të punësuarve gjithsej në vitin 2023 ka qënë 559.922, duke u rritur me 2,2 %, krahasuar me vitin 2022. Prodhuesit e shërbimeve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorët tregti, akomodim dhe shërbim ushqimor, transport dhe komunikacion dhe shërbime të tjera zënë 65,2 % të numrit të të punësuarve gjithsej. Prodhuesit e të mirave që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorët industri nxjerrëse, industri përpunuese, energji, ujë, trajtimi i mbetjeve dhe sektorin e ndërtimit, zënë 34,8 %.


Shitjet neto në vitin 2023 arritën vlerën 3.381 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 0,7 % ndaj vitit 2022. Prodhuesit e shërbimeve zënë pjesën më të madhe të shitjeve neto të realizuara duke përbërë 67,5 % të shitjeve neto gjithsej.

Tab.1 Treguesit kryesorë sipas aktivitetit ekonomik, 2023

Aktiviteti ekonomik	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shitjet neto	
	nr.	%	nr.	%	mln Lekë	%
Gjithsej	117.292	100,0	559.922	100,0	3.381.459	100,0
Prodhuesit e të mirave	15.059	12,8	195.040	34,8	1.100.034	32,5
Industri nxjerrëse	700	0,6	9.247	1,7	77.892	2,3
Industri përpunuese	7.169	6,1	103.527	18,5	390.442	11,5
En. elek. gazi. uji dhe trajtimi i mbetjeve	894	0,8	24.082	4,3	266.361	7,9
Ndërtim	6.296	5,4	58.185	10,4	365.339	10,8
Prodhuesit e shërbimeve	102.232	87,2	364.882	65,2	2.281.425	67,5
Tregti	41.848	35,7	137.057	24,5	1.539.038	45,5
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	17.850	15,2	57.009	10,2	122.864	3,6
Transp. inform.komunikacioni	10.946	9,3	49.365	8,8	255.220	7,5
Shërbime të tjera	31.588	26,9	121.451	21,7	364.302	10,8

Për publikim 18/02/2025


Fig. 1 Ndryshimet vjetore të treguesve kryesorë, 2023/2022



Ndërmarrjet në prodhuesit e të mirave kanë kontribuar me 0,3 pikë përqindje në numrin e ndërmarrjeve; 0,4 pikë përqindje në numrin e të punësuarve dhe -2,6 pikë përqindje në shitjet neto.


Ndërmarrjet në prodhuesit e shërbimeve kanë kontribuar me 3,1 pikë përqindje në numrin e ndërmarrjeve; 1,8 pikë përqindje në numrin e të punësuarve dhe 3,2 pikë përqindje në shitjet neto.

Fig. 2 Kontributi i prodhuesve të të mirave dhe shërbimeve, në ndryshimin vjetor, 2023/2022




Sektori i Shërbimeve dhe sektori i Ndërtimit kanë kontribuar përkatësisht me 1.6 pikë përqindje dhe 0,7 pikë përqindje në rritjen prej 0,7 % të shitjeve neto gjithsej.

Fig. 3 Kontributi i aktiviteteve ekonomike në ndryshimin vjetor të shitjeve neto, 2023/2022



Shitjet neto për të punësuar për vitin 2023 kanë qënë 6.039 mijë lekë nga 6.131 mijë lekë për të punësuar rezultat në vitin 2022. Ky tregues është më i lartë tek prodhuesit shërbimeve (6.253 mijë lekë për të punësuar) në krahasim me prodhuesit e të mirave (5.640 mijë lekë për të punësuar).


Fig. 4 Shitjet neto për të punësuar, 2023/2022



Ndërmarrjet e prodhimit të të mirave ku përfshihen sektorët e industrisë nxjerrëse, përpunuese, energjisë elektrike, gazit, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve si edhe ndërtimi, përbëjnë rreth 32,5 % të shitjeve neto të realizuara.

Sektori me ndikimin më të madh në prodhuesit e të mirave për numrin e ndërmarrjeve aktive (6,1 %). shitjet neto (11,5 %) dhe numrin e të punësuarve (18,5 %) ka qënë sektori i industrisë përpunuese.


Fig. 5 Struktura e treguesve bazë sipas aktiviteteve ekonomike për prodhuesit e të mirave, 2023



Në prodhuesit e shërbimeve operojnë 87,2 % e ndërmarrjeve aktive të cilat realizuan 67,5 % të shitjeve neto. Në këtë grup ndërmarrjesh rolin kryesor e luan tregtia (ku përfshihen tregtia me shumicë, me pakicë dhe riparimi i automjeteve).

Në tregti operojnë 35,7 % e ndërmarrjeve të cilat realizojnë 45,5 % të shitjeve neto gjithsej. Sektori i tregtisë kontribuoi me 0,7 pikë përqindje në rritjen vjetore prej 0,7 % të shitjeve neto. Të punësuarit në tregti zënë 24,5 % të numrit të të punësuarve gjithsej.

Fig. 6 Struktura e treguesve bazë sipas aktiviteteve ekonomike për prodhuesit e shërbimeve, 2023



Gjatë vitit 2023 ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar kanë zënë 40,6 % të numrit gjithsej të të punësuarve të cilët realizuan 46,9 % të shitjeve neto edhe pse përbëjnë vetëm 1,2 % të ndërmarrjeve aktive.


Ndërmarrjet me 1-4 të punësuar zënë 28,0 % të të punësuarve gjithsej të cilët kanë realizuar 15,4 % të shitjeve neto dhe përbëjnë 86,1 % të ndërmarrjeve aktive.

Tab. 2 Treguesit kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2023

Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shitjet neto	
	nr.	%	nr.	%	mIn Lekë	%
Gjithsej	117.292	100,0	559.922	100,0	3.381.459	100,0
1-4 të punësuar	101.030	86,1	156.897	28,0	520.302	15,4
5-9 të punësuar	8.631	7,4	55.315	9,9	316.293	9,4
10-49 të punësuar	6.176	5,3	120.564	21,5	960.531	28,4
50+ të punësuar	1.454	1,2	227.146	40,6	1.584.333	46,9

Nga rezultatet vërehet se ndërmarrjet me 50 dhe më shumë të punësuar kanë kontribuar negativisht me - 0,3 pikë përqindje në ndryshimin vjetor të shitjeve neto gjithsej. Ndërmarrjet me 1-4 të punësuar kanë kontribuar me 1,6 pikë përqindje.

Fig. 7 Kontributi në ndryshimin vjetor të shitjeve neto të ndërmarrjeve sipas madhësisë, 2023/2022



Metodologjia

Statistikat strukturore të ndërmarrjeve kanë si qëllim të tregojnë strukturën e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike. Treguesit paraqiten për aktivitetet ekonomike gjithsej, sipas degëve dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve. Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri, për të gjitha format legale (nuk përfshihen aktivitetet e bujqësisë, peshkimit, aktivitetet e ndërmjetësimit monetar dhe financiar, administrata publike dhe e mbrojtjes si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare). Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrit statistikor janë aktive në dhjetor të vitit referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik. Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë është bërë sipas numrit të punësuarve (matur si të punësuar me kohë të plotë). Për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë mostër me zgjedhje për anketim. Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht. Grumbullimi i të dhënave është kryer me intervistim të drejtpërdrejtë pranë ndërmarrjeve. Për më shumë informacion metodologjik referohuni link-ut:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/statistikat-strukturore-t%C3%AB-nd%C3%ABmarrjeve-ekonomike/>.

Rezultatet e statistikave strukturore të ndërmarrjeve në mënyrë që të jenë të përshtatshme me ato të vendeve evropiane, publikohen duke zbatuar rregulloret Komisionit Evropian:

- Rregulloren e Komisionit Evropian Nr.1893/2006 mbi "Implementimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve;
- Rregulloren e BE-së 2019/2152 mbi statistikave evropiane të biznesit (rregullorja EBS);
- Rregullen zbatuese 2020/1197 që përcakton specifikimet dhe marrëveshjet teknike (akti i përgjithshëm zbatues).

Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve 2023 publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarisë Ekonomike Rev.2. Për më shumë informacion referohuni link-ut:

<http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/klasifikime-nomenklatura/>

Aktivitetet ekonomike

	Struktura e NVE Rev.2	Aktivitetet ekonomike të përfshira në vërtim
Seksioni	Përshkrimi	
Të mirat		
A	Bujqësi,pyje dhe peshkim	-
B	Industri nxjerrëse	✓
C	Industri përpunuese	✓
D	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	✓
E	Furnizimi me ujë,aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	✓
F	Ndërtim	✓
Shërbimet		
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automobilave dhe motoçikletave	✓
I	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	✓
H	Transport dhe magazinim	✓
J	Informacioni dhe komunikacioni	✓
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	-
L	Pasuritë e patundshme	✓
M	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	✓
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse	✓
O	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm	-
P	Arsimi	✓
Q	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	✓
R	Art, argëtim dhe zbavitje	✓
S	Aktivitete të tjera shërbimi	✓
T	Shërbime në shtëpi	-
U	Aktivitete të organizatave ndërkombëtare	-

* Aktivitetet e Shërbimeve nga seksioni L në S (përfshirë S94) përfshihen në Shërbime të tjera.

Përkufizimet kryesore të treguesve bazë

Ndërmarrja është njësia më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

Shitjet neto përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me vlerën e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar. Ky variabël mund të gjendet në botimet e tjera me termat: shifra e afarizmit ose xhiro.